

Miratim
për trajtimin e të dhënave personale
në fushën e Studimit " Anketa e itinerarit nënë-fëmijë në Provincën e
Trento-s"

Plotësojmë dy kopje të formularit. Njëra do të mbahet nga personi që e regjistron dhe tjetra do t'i dorëzohet pjesëmarrësit.

Unë i/e nënshkruari/a			
lindur në		më	
rezidente në		rruga	
JAP MIRATIMIN TIM	☐	NUK E JAP MIRATIMIN TIM	☐

për **trajtimin e të dhënave të mia personale** për qëllim të kërkimeve shkencore në fushën e Studimit "Anketa e itinerarit nënë-fëmijë në Provincën e Trento-s" sipas asaj që parashikohet në informativën e mësipërme.

Ju kujtojmë se mosdhënia e miratimit për trajtimin e të dhënave personale nuk ndikon në qasjen e mundshme për kura por nënkupton vetëm pamundësinë për të marrë pjesë në Studim.

Vendi dhe data _____ Firma _____

Informativa për trajtimin e të dhënave personale (neni 13 i Rregullores BE 2016/679)

Ju informojmë se të dhënat personale që na keni furnizuar, si pjesëmarrës në Studimin " Anketa e itinerarit nënë-fëmijë në Provincën e Trento-s" do të trajtohen në përputhje me Rregulloren BE 2016/679 (në vazhdim, "**GDPR**"), Dekreti Legjislativ n. 196/2003, ashtu siç është ndryshuar nga Dekreti Legjislativ n. 101/2018 (në vazhdim, "**Kodi i Privatësisë**"), dhe çdo rregullore tjetër e detyrueshme (p.sh. ligje, dekrete legjislative, rregullore, etj.), përfshirë aty dispozitat e WP29, të Komitetit Evropian për mbrojtjen e të dhënave ("EDPB") dhe të Garantit për mbrojtjen e të dhënave personale që aplikohen herë pas here, si dhe në përputhje me informativën e mëposhtme.

Bashkëtitullarët e trajtimit

Bashkëtitullarët e trajtimit të të dhënave në lidhje me Studimin janë Ndërmarrja Provinciale e Shërbimeve Shëndetësore (Azienda Provinciale per i Servizi Sanitari - APSS), me seli ligjore në adresën A. De Gasperi n. 79 - 38123 Trento dhe Shkolla Universitare e Lartë Sant'Anna (SSSA), me seli ligjore në Piazza Martiri della Libertà, 33 56127 Pisa (në vijim, bashkërisht, "**Bashkëtitullarët**").

Ndërmjet Bashkëtitullarëve është përfunduar një marrëveshje e brendshme e bashkëtitullarëve që përshkruan përgjegjësitë e tyre përkatëse në lidhje me respektimin e detyrimeve që rrjedhin nga rregullorja e përgjithshme për mbrojtjen e të dhënave, në përputhje me nenin 26 të GDPR.

Përgjegjësi për mbrojtjen e të dhënave

Të dhënat për kontaktimin e Përgjegjësve për mbrojtjen e të dhënave janë:

- për APSS: Via A. De Gasperi, n. 79 – 38123 Trento, e-mail: ResponsabileProtezioneDati@apss.tn.it;
- për SSSA: Piazza Martiri della Libertà, 33 56127 Pisa, e-mail dpo@santannapisa.it

Qëllimet e trajtimit

Të dhënat tuaja personale trajtohen nga ana e APSS dhe ISSA për qëllime kërkimesh shkencore dhe statistikash.

Baza ligjore e trajtimit

Trajtimi i dhënave tuaja personale nga Bashkëtitullarët për qëllimin e treguar më sipër kërkon miratimin tuaj të qartë, në përputhje me nenin 6 par. 1 germa a) dhe të nenit 9, par. 2 germa a) të GDPR. Mosdhënia e miratimit për trajtimin e të dhënave personale nuk ndikon në qasjen e mundshme për kurat, por vetëm nënkupton pamundësinë e pjesëmarrjes në Projekt.

Kategoria dhe tipologjia e të dhënave personale të trajtuara

Realizimi i qëllimeve të këtij Projekti nënkupton mbledhjen dhe trajtimin e të dhënave personale të zakonshme (për shembull, adresën e postës elektronike e-mail, telefonin celular), por edhe të dhënat që kanë lidhje me shëndetin, që bëjnë pjesë në kategoritë e veçanta të të dhënave personale të përmendura në nenin 9, Rregullorja (BE) 2016/679.

Modaliteti për trajtimin e të dhënave

Të dhënat e mbledhura trajtohen për qëllimet e lartpërmendura, me ndihmën e mjeteve informatike dhe në formë letrë, të përshtatshme për të garantuar sigurinë dhe privatësinë e të dhënave. Çdo operacion i trajtimit të të dhënave do të bazohet në parimet e korrektësisë, ligjshmërisë dhe transparencës të vendosura nga dekreti D.Lgs. 196/2003 dhe nga Rregullorja (BE) 2016/679.

Në veçanti, Anketa fillon në momentin e kontaktit të parë me maminë ose me specialistin gjinekolog të APSS-së: me këtë rast do t'u kërkohet nënave të ardhshme të lënë një adresë e-mail dhe numrin e celularit. Në këtë mënyrë pjesëmarrësit e anketës do të kontaktohen periodikisht për të plotësuar pyetësorë të shkurtër në internet. Pyetësorët kanë të bëjnë me përvojën e jetuar gjatë shtatzënisë, lindjes së fëmijës, ushqimit me gji, përkujdesjes ndaj fëmijës në vitin e tij të parë të jetës dhe perceptimin e gjendjes së tij shëndetësore. Pas përfundimit të

pyetësorit, pjesëmarrësja do të marrë një komunikim me anën e postës elektronike me informacionet në lidhje me rrugëtimin e nënë-fëmijës, për shërbimet dhe disa përkujtesa të rëndësishme për të mbrojtur dhe promovuar shëndetin e saj dhe atë të fëmijës së saj.

Në veçanti, të dhënat e përfshira në pyetësorët e Anketës mbi rrugëtimin nënë-fëmijë janë të mbledhura në një bazë të dhënash, në një server të Laboratorit të Menagjimit dhe Shëndetit të Shkollës Sant'Anna në Pisa (Scuola Sant'Anna di Pisa) i cili koordinon anketën, i vendosur në Pisa (Itali) dhe që trajtohen me anën e instrumenteve informatikë duke përdorur një softuer të veçantë që lejon ndarjen e të dhënave personale në lidhje me përgjigjet. Ndiqen masa specifike sigurie për të parandaluar humbjen e të dhënave, përdorimin e paligjshëm ose jo korrekt dhe qasjet e paautorizuara, ndërmjet të cilave përdorimin e një protokollit të sigurt të transmetimit nga APSS në Laboratorin e Menagjimit dhe Shëndetit të Shkollës Sant'Ana në Pisa (Scuola Sant'Anna di Pisa).

Të gjitha të dhënat personale do të trajtohen duke përdorur teknikat e kriptimit të të dhënave dhe pseudonimizimit, në mënyrë që të vlerësohet rrugëtimi nënë-fëmijë në kuadrin e projektit të promovuar nga Provinca Autonome e Trento-s. Rezultatet e Anketës do të shpallen dhe do t'i kthehen APSS-së dhe Provincës Autonome të Trento-s në formë anonime ose të agreguar.

Nuk parashikohen në asnjë mënyrë procese të automatizuara të vendimmarrjes në përputhje me nenin 22 të GDPR.

Periudha e ruajtjes së të dhënave

Të dhënat tuaja personale të mbledhura, duke përfshirë edhe plotësimin e pyetësorëve, do të ruhen vetëm për kohën rigorozisht të nevojshme për Studimin dhe pastaj do të eliminohen menjëherë, ose do të përdoren në formë anonime për qëllime kërkimore nga ana e Shkollës.

Natyra e dorëzimit të të dhënave dhe pasojat e mosdhënies së tyre

Dorëzimi i të dhënave tuaja për qëllimet e lartpërmendura është fakultativ. Mospranimi për regjistrimin e të dhënave tuaja, do ta bëjë të pamundur pjesëmarrjen tuaj në Projekt por kjo gjë nuk do të ketë pasoja në ofrimin e shërbimeve sanitare.

Kujt i drejtohen të dhënat

Të dhënat personale trajtohen, ekskluzivisht për qëllimet e lartpërmendura, nga personeli i autorizuar i APSS-së, në cilësinë e tij si "Përgjegjës për trajtimin/i Autorizuar për trajtimin", si dhe nga studiuesit e specializuar dhe të autorizuar për këtë qëllim, të Laboratorit MeS të Shkollës së Lartë Sant'Ana në Pisa (Scuola Superiore S.Anna di Pisa). Të dhënat personale nuk do të transferohen në vendet jashtë BE-së.

Rezultatet e Projektit mund të shpërndahen me anën e publikimit të rezultateve statistikore, por vetëm në formë agregate ose, në çdo rast, sipas modaliteteve që nuk i bëjnë personat e interesuar të identifikueshëm as edhe nëpërmjet të dhënave të identifikimit indirekte.

Të dhënat tuaja personale në lidhje gjendjen e shëndetit nuk do të jenë objekt i shpërndarjes, në asnjë mënyrë.

Të drejtat e personit të interesuar

Në cilësinë e tij si person i interesuar, ka të drejtë të kërkojë në çdo kohë nga Bashkëtitullarët që të ushtrojë të drejtat e përcaktuara në nenet 15 e në vazhdim të GDPR dhe, veçanërisht:

- të kërkojë konfirmimin e ekzistencës ose jo të të dhënave të tija personale;
- të marrë udhëzimet në lidhje me qëllimet e trajtimit, kategoritë e të dhënave personale, marrësit ose kategoritë e marrësve të cilëve u janë komunikuar ose do t'u komunikohen të dhënat personale dhe, kur është e mundur, periudha e ruajtjes së tyre;
- të sigurojë korrigjimin dhe eliminimin e të dhënave personale;
- të përfitojë kufizimin e trajtimit;
- të kundërshtojë trajtimin në çdo kohë.

Personi i interesuar, përveç kësaj ka të drejtë të revokojë miratimin në çdo kohë pa ndikuar në ligjshmërinë e trajtimit, që është i bazuar në miratimin e dhënë përpara revokimit.

Nëse personi i interesuar vendos të tërhiqet nga Projekti, të dhënat e tija do të eliminohen pasi ato nuk mund të përdoren më për qëllimet e Studimit.

Për ushtrimin e të drejtave të lartpërmendura, personi i interesuar mund të kontaktojë:

- për APSS, drejtuar Përgjegjësit për mbrojtjen e të dhënave personale - Via A. De Gasperi, n. 79 – 38123 Trento, e-mail: ResponsabileProtezioneDati@apss.tn.it;
- për SSSA: privacy@santannapisa.it

Mbetet në fuqi e drejta për të paraqitur ankesë te Garanti për mbrojtjen e të dhënave personale.

Ju falënderojmë për kohën që i keni dedikuar leximit të këtij shënimi informativ dhe për pjesëmarrjen në Studim.